



KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

**RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT
TË MINISTRISË SË DREJTËSISË
2022**

www.drejtesia.gov.al

Përmbledhje Ekzekutive

Qasja vlerësuese

Metodologjia e monitorimit

Gjetjet e raportit

Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e

Drejtësisë

Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së

Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun

Konkluzione dhe rekomandime

Hapa të tjera

Aneks

Lista e shkurtesave

AB	Auditi i Brendshëm
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BNJ	Burime Njerëzore
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DRÇD	Drejtoria Rregullatore për Çështjet e Drejtësisë
DPSD	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në fushën e Drejtësisë
DPKHL	Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit
DMJBN	Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale dhe Bashkëpunimit Ndërgjyqësor
DPPD	Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë
DPPAK	Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën e Antikorrupsionit
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MD	Ministria e Drejtësisë
PI	Plan Integriteti
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PT	Programi i Transparencës
PSV	Procedura Standarte Veprimi
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
NSSP	Paketa Kombëtare të Projekteve Strategjike
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përmbledhje Ekzekutive

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, është përgjegjëse dhe koordinuese për objektivat A.8 dhe A.9 të SNKK-së, që materializojnë forcimin e integritetit në administratën publike. Në zbatim të këtyre objektivëve, gjatë vitit 2020, Ministria e Drejtësisë hartoi dhe miratoi për së pari, dy instrumente me karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit: Planin e Integritetit të institucionit, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.333, datë 07.10.2020; dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020, me zbatimin e të cilës do të mundësonte replikimin e planeve të integritetit të institucionet e tjera të administratës qendrore me kompetenca ekzekutive, përkatësisht ministrinë fillimisht dhe varësitë e tyre në vijim.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuar në 12 fusha të përgjegjësisë institucionale të ministrisë.

Plani i Integritetit përmban gjithsej 112 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2023.

Në përputhje me kreun 3, pika 3.1 të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Drejtësisë ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti i monitorimit për zbatimin e Planit të Integritetit 2022, jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë për periudhën e kërkuar, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, problematikën e hasura në zbatimin e tyre, përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të njërive (drejtorive) të brendshme kontribuuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.


Për vitin 2022, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 16 masa për të cilat janë planifikuar kryerja e 46 aktivitete, të shpërndara në tre objektiva, përkatësisht:

Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e Drejtësisë

Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun.

Nga monitorimi rezulton se përgjatë vitit 2022, në totalin prej 16 masash, janë zbatuar 12 masa, 3 prej tyre kanë mbetur në proces dhe 1 masë nuk është realizuar.



Gjatë vitit 2022, masa dhe aktivitetet e lidhura me përditësimin e rregullores së institucionit u realizuan dhe u përfshinë në tekstin e saj, me miratimin e rregullores së brendshme të Ministrisë së Drejtësisë, me urdhër të ministrit, nr.116, datë 30.3.2022, “Për miratimin e rregullores, për miratimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”. Përmendim, kuadrin e plotë rregullator për etikën dhe integritetin, si dhe ndërhyrjet dhe reflektimet rregullore të strukturave teknike të institucionit si dhe ndërhyrjet në dispozitat e rregullores së brendshme për konfliktin e interesave privatë, dhuratat dhe sponsorizimet, lobistët, veprimtari të jashtëm, sinjalizimin si dhe rregullimin e komunikimit ndërmjet strukturave teknike të brendshme dhe gjithashtu me grupe jashtë institucionit.

Gjatë vitit 2022, evidentohet fakti i miratimit të programit vjetor të inspektimit të noterëve, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr.51, datë 03.02.2022, në funksion të garantimit dhe kryerjen e detyrave prej noterit në përputhje me ligjin, duke u udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore në përputhje me standardet e parashikuara. Programi ka si qëllim garantimin dhe kryerjen e detyrave prej noterit në përputhje me ligjin, duke u udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore në përputhje me standardet e parashikuara në legjislacionin noterial.

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raporteve të performancës dhe ato të auditimit (të brendshëm dhe të jashtëm).

Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit ka miratuar strukturën e re të përbërë prej 19 pozicionesh mbështetur në urdhrin e Kryeministrit, nr.196, datë 2.12.2022, “Për një ndryshim në urdhrin nr.128, datë 8.11.2021, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”” si dhe janë zhvilluar trajnime në bashkëpunim me ASPA, për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit teknik të saj.

Gjatë vitit 2022, janë zhvilluar seanca trajnime për të gjithë stafin teknik të MD-së në bashkërendim dhe planifikim të sektorit të Burimeve Njerëzore me ASPA, gjithashtu.

Të gjitha masat dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2022, janë mbuluar nga buxheti i shtetit me një vlerë prej 404,969,964 lekë.

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit dhe performancës në MD, Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit të vitit 2022, për aktivitete dhe masa të kuadrit rregullator në MD, të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të organizimi dhe funksionimit të strukturave teknike të Ministrisë së Drejtësisë.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 6 drejtorive dhe strukturave teknike në Ministrinë e Drejtësisë, për të cilat ka pasur të parashikuar masa për zbatim për vitin 2022 dhe ecuri e deritanishme e tyre. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit¹ të Ministrisë së Drejtësisë, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatori i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme (referohu: seksioni Nr. 2.2.6 të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet qendrore).

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuuese në këtë raport, të cilat janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave në Fushën e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore në Fushën e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumenta të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; rekomandime dhe konkluzione.

Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Gjetjet e Raportit

■ **Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e**

Drejtësisë

Përmes këtij objektivi synohet përmirësimi dhe forcimi i integritetit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator për çështje të veçanta të integritetit si dhe gjithashtu të miratimit dhe përmirësimit të kuadrit të brendshëm institucional në menaxhimin e integritetit në institucional.


Ky objektivi përmban një numër prej 8 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave në Fushën e

¹ Koordinator i Integritetit është përfaqësues i Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion.

Drejtësisë (nëpërmjet Drejtorisë së Projekteve në Fushën e Drejtësisë); Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore në Fushën e Drejtësisë (nëpërmjet Drejtorisë për Çështjet e Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë); dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse (nëpërmjet Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve dhe të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar).

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 6 masa të zbatuar plotësisht, 1 në proces zbatimi, 1 e pazbatuar, përfshirë edhe masat për të cilat mungon raportimi. (në aneksin e raportit: masa 1.6).

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Kuadër rregullator për integritetin	Masa/ Aktivitete	8	6	1	1



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor* 2022, Drejtoria për Çështjet e Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, në përmbushje të angazhimit për krijimin e metodologjisë për inspektimin e institucioneve të varësisë, ka kryer një vlerësim të kuadrit ligjor duke konstatuar se Ministria e Drejtësisë kryen aktualisht inspektimet bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse specifike që rregullojnë secilën fushë.

Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë ka realizuar rregullisht konsultimin dhe prioritizimin e projekt-propozimeve të dërguara nga institucionet e varësisë dhe organet e sistemit të drejtësisë, të cilat propozohen në takimin vjetor të KPS-së me qëllim evidentimin e projekt-propozimeve prioritare në fushën e drejtësisë, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga SASPAC. Raporti final vjetor për to, finalizohet në 3-mujorin e parë të vitit pasardhës, 2023. Gjithashtu, është ndjekur dhe koordinuar procesi i NSSP (Paketa Kombëtare të Projekteve Strategjike) mbi projektet prioritare të Ministrisë së Drejtësisë dhe hartuar paketa e Projekteve/Single project Pipeline (SSPP) për sektorin social në fushën e drejtësisë, me koordinimin midis institucioneve të varësisë dhe drejtorive pranë MD-së.

Në këtë periudhë zbatimi janë zhvilluar takime me institucionet për koordimin e projekteve, përkatësisht: në mars 2022, për ndryshimin e indikatorëve të kontratës Sektoriale, dhe në maj 2022, për zbatimin e Kontratës Sektoriale me institucionet e pavarura dhe ato të varësisë. Ka vijuar puna për hartimin e manualit për raportimin periodik mbi ecurinë e projekteve, me përgatitjen e një draft-dokumenti, i cili po rishikohet për përmirësime të mundshme nga projekti JustAL, SASPAK dhe Ministria e Drejtësisë. Është realizuar vlerësimi i nevojave të institucioneve të varësisë mbi projektet që ata aplikojnë dhe kanë nevoja. Procesi është lehtësuar me miratimin e urdhrat të Ministrit të Drejtësisë, nr.149, datë 20.04.2022, “Për organizimin dhe bashkërendimin e punës në kuadër të ndjekjes së detyrave për menaxhimin e projekteve të fondeve IPA dhe donatorëve të tjerë në funksion të sistemit të drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë”, dhe që ka rakorduar bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse për të raportuar në mënyrë periodike.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, informoi për rishikimin dhe ndërhyrjet në buxhetin e institucionit në vlerën e buxhetit të përdorur për vitin 2022, në 430,077,614 Lek dhe buxheti i përdorur është 404,969,964 Lek. Në analizë të shifrave, nuk ka pasur ndryshime të kryera në buxhet për shkak se buxheti i parashikuar është më i ulët se buxheti i përdorur.

Për periudhën raportuese të vitit 2022, me miratimin e rregullores së brendshme të Ministrisë së Drejtësisë, me urdhër të ministrit, nr.116, datë 30.3.2022, “Për miratimin e rregullores, për miratimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, janë formalizuar dhe përfshirë në të, përkatësisht: procesi i planifikimit vjetor dhe ndërveprimi i njësive të MD-së në kuadër të këtij planifikimit vjetor.

Rezulton se është parashikuar në rregulloren e brendshme, në nenin 47 të saj, “*Marrëdhëniet mes strukturave paralele apo në nivel horizontal janë marrëdhënie bashkëpunimi. Në këto marrëdhënie spikat në rolin drejtues struktura, e cila mbulon fushën përkatëse të drejtimit. Ky bashkëpunim zhvillohet gjithnjë në bazë të programeve vjetore të miratuara të Ministrisë së Drejtësisë. Drejtoritë e Ministrisë janë të detyruara të bashkëpunojnë me njëra tjetrën për çështje të përbashkëta.*”

Gjatë vitit 2022 është miratuar programi vjetor i inspektimit të noterëve, për vitin 2022, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr.51, datë 03.02.2022 si dhe është kryer rregullisht publikimi i urdhrave të Ministrit të Drejtësisë në faqen zyrtare për çdo vendimmarrje mbi inspektimet e kryera. Programi ka si qëllim garantimin dhe kryerjen e detyrave prej noterit në përputhje me ligjin, duke

u udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore në përputhje me standardet e parashikuara në legjislacionin noterial. Programi është hartuar duke marrë në konsideratë rekomandimet në kuadër të luftës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ku një pjesë e inspektimeve që do realizohen janë kundrejt subjekteve noteriale të cilat konsiderohen si me risk të lartë.

Gjatë periudhës raportuese për vitin 2022, inspektimet e kryera janë:

- 36 inspektime të përgjithshme. Masa të marra:
 - 10 heqje licence
 - 7 pezullime
 - 6 masa të tjera
- 4 inspektime janë në proces

Aktiviteti i fushës së prokurimeve publike është plotësisht i mbështetur në bashkëpunimin e evidentimin të aktiviteteve vjetore dhe në hartimin e një Plan-Buxheti dhe Regjistri ëe Parashikimeve të Prokurimeve të plotë e gjithëpërfshirës. Nuk aplikohen çmime preferenciale pasi është i detyrueshëm përdorimi i Sistemit Dinamik, siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik. Cdo procedurë blerjeje zhvillohet online në Sistemin e Prokurimit Elektronik, duke bërë të mundur pjesëmarrje të gjerë operatorësh, konkurrencë dhe përdorim efektiv të fondeve (çmimi më i lirë).

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

■ **Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit**

Përmes këtij objektivi synohet mirëfunksionimi i administratës të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet vendosjes së linjave të qarta hierarkike, sanksionimit të një procedure të qartë të të gjitha proceseve të punës në njësitë e ministrisë, forcimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale të fushës por edhe rekrutimin e stafit në mungesë në përputhje me strukturën dhe organikën në fuqi të ministrisë.

Ky objektivi përmban një numër prej 7 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht hartimit të proceseve të punës (hartës); plotësisht të vakancave në sektorë dhe drejtori të MD; forcimit të kapaciteteve profesionale. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore në Fushën e Drejtësisë (nëpërmjet Drejtorisë për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor); dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse (nëpërmjet Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve).

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 5 masa të zbatuar plotësisht, 2 në proces zbatimi, 0 të pazbatuara.

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Burime njerëzore të qëndrueshme dhe të kualifikuara	Masa/ Aktivitete	7	5	2	0



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor* 2022, është miratuar dhe ka filluar zbatimi nga struktura e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si pjesë e strukturës së Ministrisë së Drejtësisë, dhe të miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.128, datë 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”. Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, është plotësuar vendi vakant i drejtorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe vendi vakant për përgjegjës të financës.

Trajnimet dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të nëpunësve të ministrisë kryhen në koordinim me ASPA-n. Plani dhe programi hartohet dhe miratohet nga ASPA. SBNj ka dërguar pranë ASPA planifikimin e nevojave për trajnim dhe temat për trajnim për punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varësisë së saj për vitin 2022, me shkresën nr.6199, datë 20.12.2021, përfshirë këtu edhe për Koordinatorin e Menaxhimit të Riskut Financiar.

Përsa i takon zbatimit të masës 2.3, lidhur me marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vendeve të lira të punës me persona që kanë vendime gjyqësore të formës së prerë, në përputhje me ligjin për nëpunësit civilë dhe aktet nënligjore të tij (udhëzimi për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë), si me rastin e lirimit të vendeve të punës, apo me rastin e riskstrukturimeve institucionale, ashtu edhe në vijimësi, rezulton se në mbështetje të Urdhrit nr.5151, datë 28.10.2015, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Komisioni i posacem ka shqyrtuar dhe ka propozuar pranë DAP emerimin e 3 gjyq-fituesve.

Sa i përket analizës së performancës, Ministria e Drejtësisë ka kryer një analizë të institucionit për të gjitha drejtoritë e saj, duke evidentuar objektivat e ardhshëm për secilën njësi të institucionit. Mënyra e raportimit mbi ecurinë dhe zbatueshmërinë kryhet në format të gatshëm, ku përcaktohen objektivat dhe hapat e ndërmarrë nga njësitë përkatëse. Raportimi në Kartën e Performancës kryhet në interval kohe për çdo javë. Analiza për ecurinë në objektivat e parashikuar kryhet nga Ministria e Drejtësisë duke rekomanduar njësitë e ministrisë për ndryshime që duhen bërë në funksion të përmirësimit të performancës.

Trajnimet dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të nëpunësve të ministrisë kryhet në koordinim me ASPA-n. Plani dhe programi hartohet dhe miratohet nga ASPA. Sektori i burimeve njerëzore në MD-së, ka dërguar pranë ASPA planifikimin për trajnime sipas kërkesave të punonjësve, si dhe mban një evidencë mbi numrin e të trajnuarve sipas nivelit dhe fushës përkatëse. Gjatë vitit 2022, nëpërmjet ASPA me e-mailin e datë 02.02.2022, të gjithë stafit i është vënë në dispozicion kalendari i trajnimeve për muajin Shkurt 2022, i cili ka parashikuar rreth 48 webinare të cilat mund të ndiqen nga punonjësit në përputhje me kërkesat e tyre. (Sa i përket metodologjisë së parashikuar për vlerësimin, në formularin e vlerësimit të performancës, ndarja E, i dedikohet Plani i zhvillimit profesional të nëpunësit, hapsirë në të cilën evidentohet dhe ecuria për të gjithë nëpunësit.)

Sa i përket strukturës së Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira, pozicionet e punës janë të miratuara me Urdhër nr.128, datë 08.11.2021, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”. Përshkrimet e punës kanë të përcaktuara kriteret dhe janë hartuar bazuar në rregullat e përcaktuara në VKM nr.142, datë 12.3.2014 " Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës".

Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, është kryer një analizë për nevojat e burimeve njerëzore për Drejtorinë e Monitorimit të Profesioneve të Lira, rezulton se gjatë vitit 2022, drejtoria është plotësuar me 8 vende vakante gjithsej.

Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit në bazë të urdhrit të Kryeministrit, nr.196, datë 2.12.2022, Një ndryshim në urdhrin nr.128, datë 8.11.2021, “Për miratimin e

strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, ka të miratuar strukturën e re të përbërë prej 19 pozicionesh. Pas vlerësimit dhe analizimit të strukturës, të zhvilluara me Departamentin e Administratës Publike, ka plotësuar 4 vende vakante gjithsej. Në këtë drejtori janë zhvilluar trajnime në bashkëpunim me ASPA, sipas kërkesave të punonjësve.

Vlerësimi i nevojës për shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale dhe të Bashkëpunimit Gjyqësor, në bashkëpunim me DAP, është kryer procedura për plotësimin e vendeve vakante, rezulton se gjatë vitit 2022 janë plotësuar 2 vende vakante gjithsej.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun

Përmes këtij objektivi synohet rritja dhe përmirësimi i transparencës dhe veprimtarisë së institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, kundrejt grupeve të interesit dhe publikut nëpërmjet zbatimit dhe përdorimit të instrumenteve të të drejtës së informimit, konsultimit publik, të tjera forma të bashkëveprimit aktiv institucion të interesuar.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë kryesisht strukturat që prodhojnë raporte apo janë subjekt i auditimeve dhe kontroleve, si dhe funksionet e koordinatorit të drejtës së informimit dhe ai i konsultimit publik.

Ky objektivi përmban vetëm 1 masë specifike të planifikuar dhe të zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht transparencës dhe informimit të publikut mbi aktivitetin dhe performancën e Ministrisë së Drejtësisë, gjatë vitit 2022.

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuar
Transparenca e MD	Masa/ Aktivitete	1	1	-	-



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor* 2022, Ministria ka siguruar transparencë të plotë dhe të mirë për aktivitetin e saj operacional dhe organizativ. Në link: <https://www.drejtësia.gov.al/publikime/> dhe <https://www.drejtësia.gov.al/transparenca/> mund të gjenden lehtësisht publikime dhe të dhëna.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2022, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Ministria e Drejtësisë ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit.
- Është miratuar dhe ka filluar nga zbatimi rregullorja e re e Ministrisë së Drejtësisë (detyrë e lënë në raportin vjetor të monitorimit të PI).
- Ka përmirësime në koordinimin dhe projektimin e nismave dhe iniciativave, për të siguruar bashkëpunime edhe për institucionet e varësisë së ministrisë.
- Është miratuar programi vjetor i inspektimit të noterëve.
- Janë rikthyer në detyrë ish-punonjës gjyq-fitues.
- Garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.drejtësia.gov.al.

Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin dhe raportimin e masave dhe angazhimeve, si: në fushën e burimeve njerëzore; të analizohet, në çdo rast para paraqitjes së kërkesave për plotësimin e vendeve të lira të punës, gjendja e vendimeve të formës së prerë për rikthimin në vendin e punës.
- Të propozohen masa konkrete, përfshirë dhe ato disiplinore për persona që kanë dhënë vendime largimi nga puna, të cilat janë cilësuar si të paligjshme, për rastet e shfuqizimeve të vendimeve të largimit nga puna.
- Të identifikohen problematikat në kuadër të shkeljes së ligjit për rastet e dhënies së vendimeve të largimit nga puna. Sektori i çështjeve gjyqësore dhe SBNJ të realizojnë takime informuese të brendshme lidhur me këto problematika.
- Të shikohet mundësai e hartimit dhe miratimi të një manuali për raportim periodik mbi ecurinë e të gjitha projekteve në fushën e drejtësisë.
- Plotësimi i strukturave përkatëse në 3 sektorët e Drejtorisë për Çështjet e Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë me specialistë të përhershëm si dhe trajnimi i tyre mbetet t'u realizuar ne vijim pasi siguron vijueshmerinë ne proceset e punës dhe cilësinë në kryerjen e detyrave.
- Procesi i menaxhimit financiar të kryhet në përputhje me kuadrin rregullativ.
- Drejtorja e Monitorimit të Profesioneve të Lira të vijojë me trajnimet mbi sistemin ALBIS dhe RNSH.
- Të plotësohen të gjitha vakancat e evidentuara në çdo drejtori.

Aneks

- Aneksi i raportimit të informacionit nga njësitë kontribuuese